



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 596/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimeve të Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 - *Menaxhimi i Biznesit dhe Ndermarresia, BSc 180 ECTS; me kuotë 120 studente për vit akademik.*
 - *Menaxhim dhe Inovacion ne Turizem, MSc 120 ECTS; me kuotë 40 studente për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhimi i Biznesit dhe Ndermarresia, BSc 180 ECTS;</i>	Ismail Mehmeti, Sokol Krasniqi, Bislim Lekiqi dhe Aziz Rexhepi.

2.	<i>Menaxhim dhe Inovacion ne Turizem, MSc 120 ECTS;</i>	Artan Veseli dhe Afrim Loku.
----	---	---------------------------------

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Menaxhimi i Biznesit dhe Ndermarresia, BSc 180 ECTS; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 20.03.2025 me këtë përbërje: Marina Gregoric, Rocio Martinez Torres dhe Arnoldas Solovjovas. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; Menaxhim dhe Inovacion ne Turizem, MSc 120 ECTS;; vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 08.04.2025 me këtë përbërje: Marina Gregoric, Tornike Khoshtaria dhe Christoph Back. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,